RAPORT I PUNËS
(Prill - Qershor 2025)

Prishtinë, Korrik 2025

Përmbajtja

Lista e shkurtesave 3
Për Ne 4
Departamenti i financave 5
Të ardhurat dhe fitimet 5
Shpenzimet 5
Departamenti Ligjor dhe Administrata 7
Departamenti i shitjes dhe marketingut 9

Lista e shkurtesave

NPL – Ndërmarrje publike lokale
KQ- Kuzhina Qendrore
KK – Kuvendi Komunal
KP- Komuna e Prishtinës
KA – Komisioni i Aksionarëve
KB - Kryesuesi i Bordit
DB – Drejtorët e Bordit
KAB – Komisioni i Auditimit të Brendshëm
KE – Kryeshefi Ekzekutiv
IP - Institucionet Parashkollore.
BZ - Brigada e Zjarrfikësve
SHF- Shkolla Fillore

Për Ne

Ku'zina është themeluar me datën 5 Qershor 2019 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Ku'zina aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet, përveç këtyre aktiviteti i Ku'zines është shtrirë edhe tek Shtëpia e të moshuarve dhe Brigada e Zjarrfikësve. Një aktivitet që po shënon rritje në vazhdimësi është sektori privat, ku në veçanti jemi duke u rritur tek pjesa e kateringut.
Ku'zina është një koncept i kuzhinës që përfshin përgatitjen dhe gatimin e ushqimit në një vend të centralizuar, i cili më pas shpërndahet në vende të ndryshme për konsum. Kjo metodë përdoret shpesh nga zinxhirët e restoranteve, hotelet, spitalet, dhe institucionet e tjera që kanë nevojë të përgatisin ushqim në sasi të mëdha dhe ta shpërndajnë atë në disa pika shërbimi.
Përparësitë kryesore të një kuzhine qendrore përfshijnë:
Konsistenca në cilësi: Duke përgatitur të gjitha pjatat në një vend të vetëm, është më e lehtë të sigurohet që cilësia dhe shija e ushqimit të jetë e njëjtë në të gjitha pikat e shërbimit.
Kostot e reduktuara: Blerjet në sasi të mëdha dhe proceset e standardizuara të përgatitjes ndihmojnë në uljen e kostove.
Efikasiteti operativ: Ku'zina qendrore mund të përdorë teknologji dhe pajisje të avancuara që mund të jenë të shtrenjta për t'u vendosur në çdo pikë individuale shërbimi.
Kontrolli më i mirë i higjienës: Meqenëse përgatitja dhe gatimi kryhen në një vend të vetëm, është më e lehtë të kontrollohen standardet e higjienës dhe sigurisë ushqimore.
Në thelb, Ku'zina funksionon si një "fabrikë" ushqimi që shpërndan produkte gjysmë të gatshme ose të gatshme për konsum në vende të ndryshme.

Departamenti i financave

Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes se ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e parë e vitit 2025 ka arritur vlerën 595,159.75 euro, në të njejtën periudhë vitin 2024 kemi pasur të hyra 301,482.85 euro që këtë vit i bie 293,676.9 euro më shumë. Kjo rritje është shtuar me të hyrat nga procesi i mësimit tëre ditorë në Shkollat fillore të Kryeqytetit.
Trend rënes kemi tek të hyrat nga Operatorët Privat ku kemi një renie krahasur me vitin 2024 për 5,628.37 euro. Ky trend i lehte rënës ka ndodhur në muajin Mars dhe këtu besohet se ka ndikuar muaji i Ramazanit.

Shitje TM2 2025	**IP, QS, SHP,BZ, SHF**	**Op.Privat**	**Totali**
Prill	183,879.66	4,655.75	188,535.41
Maj	208,422.54	4,304.91	212,727.45
Qershor	145,776.19	4,118.13	149,894.32
Totali	538,078.39	13,079.79	515,157.18

Në tre mujorin e parë të vitit 2025, Ndërmarrja ka ndarë buxhet prej 201,715.87 euro për paga. Krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjte kemi shtim të buxhetit prej 67,029.8 euro. Ky ndryshim ka ndodhur si rrjedhoje e ndryshimit të numrit të punëtoreve dhe rritjes se pagave krahasuar me vitin paraprak.

Viti 2025	**Paga Bruto**
Muaji Prill	68,266.90
Muaji Maj	68,652.00
Muaji Qershor	60,536.73
Totali për tre muaj	197,455.7

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre mujori të parë.


Në vitin 2024 vlera totale e shpenzimeve për ketë periudhe ka qenë 121,387.57 euro Ketë vit kemi 166,052.27 më shume sepse kemi pasur shtim të kerkesës për lende të pare. Gjithashtu shohim që vlera e shitur është në proporcion te drejte me vlerën e blerjes së lendes së pare. Në ketë periudhe janë shtuar shpenzimet për Hartimin e Stretegjise Zhvillimore në vlerë 41,741.53 euro.

Tabela e shpenzimeve

	Prill	**Maj**	**Qershor**	**Totali**
Totali i shpenzimve	**119,837.17**	**58,947.36**	**49,179.15**	**227,963.68**
Lënda e parë	52,674.35	44,527.84	37,142.65	**134,344.84**
Shpenzime për naftë	653.39	759.01	792.83	**2.205.23**
Shpenzime për telefon	84.99	40.45	35.75	**161.19**
IKSHPK	0		77.69	**77.69**
Shpenzime të reprezentacionit	125.67	144.07	52.00	**321.74**
Shpenzime tjera (ushqimit)	0	0	77.97	**77.97**
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	**152.55**
Shpenzime të rrymës	1,537.46	1,867.61	0	**3,405.07**
Shpenzime për material shpenzues	45.55	130.97	0	**176.52**
Shpenzimet për zyre	35.93	103.27	164.82	**304.02**
Shpenzimet e mirembajtjes se objektit (DDD)	83.90			**83.90**
Shpenzimet e higjienës	0	318.47	312.80	**631.27**
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave,sigurimi dhe servisim	904.04	0	7.00	**911.04**
Shpenzimet e paketimeve	527.81	1,147.12	203.39	**1,878.32**
Shpenzimet e qirase së veturave	6,766.10	6,766.10	6,766.10	**20,298.30**
Shpenzimet e transportit	11,514.00	0	1,428.00	**12,942.00**
Shpenzimet e transportit jasht vendit	980.00	0	0	**980.00**
Shpenzimet e sigurimit shëndetsor	2,111.60	2111.60	2,067.30	**6,290.50**
Hartimi I strategjise zhvillimore	41,741.53	0	0	**41,741.53**

Shpenzimet e Auditimit		980.00		**980.00**

Përmbledhje:



Departamenti ligjor dhe administrata

Ky raport përmbledh aktivitetet dhe rezultatet e arritura nga Departamenti Ligjor dhe Administrata i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A., gjatë tremujorit të parë të vitit 2025. Gjatë kësaj periudhe, departamenti ka vepruar në përputhje me kërkesat organizative dhe detyrimet ligjore, duke kontribuar në konsolidimin e kornizës rregullative dhe mbështetjen administrative të ndërmarrjes.

Fokus i veçantë i punës ka qenë sigurimi i funksionimit efikas të strukturave vendimmarrëse, menaxhimi korrekt i dokumentacionit ligjor, si dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe shërbimeve për stafin.

2. Aktivitetet kryesore të realizuara

- Pjesmarrës në përpilimin e Rekomandimit nga Komisioni për gjetjen e objektit.
- Lidhja e kontatës me NPL Trafiku Urban për transportin e punonjësve të Kuzhinës.
- Lidhjen e Memorandum bashkëpunimin me Humanity First për furnzim me mish Gjedhi për nevoja të kuzhinës përkatësisht për përgaditjen e ushqimit për përsonat me asistence sociale.
- Menaxhimi i kontratës kolektive për sigurimin shëndetësor të punonjësve, në bashkëpunim me subjektet relevante dhe në përputhje me interesin e punonjësve.
- Draftimi dhe finalizimi i kontratave komerciale me operatorë ekonomikë privatë për ofrimin e shujtave ushqimore për punonjësit.

3. Vendime dhe dokumente të lëshuara

3.1 Vendime të departamentit

- Vendim për trajtimin e çështjeve të përgjegjësisë disiplinore dhe materiale, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullores së brendshme.
- Autorizime varësisht prej nevojave të Ndërmarrjes.

3.2 Njoftime dhe dokumente administrativë

- Lëshimi i vërtetimeve të ndryshme për punonjësit dhe komunikime zyrtare për organizimin dhe funksionimin optimal të punës në ndërmarrje.
- Përgatitja dhe shpërndarja e shkresave zyrtare për koordinimin ndërdepartamental dhe raportimin institucional.

Departamentin e Shërbimeve të Përbashkëta

Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta në tre mujorin e dytë të vitit 2025 ka pasur këto angazhime:

Në bazë të rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes si dhe në bazë të kontratës “Në Shtëpi” që ndërmarrja jonë N.P.L “Ku’zina” sh.a ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Shërbimeve të përbashkëta në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjelle procesin e dërgimit të shujtave në Institucionet Parashkollore, gjithashtu kemi kryer regjistrimin e shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës.

Duhet të theksoj në cilësinë e menaxherit të kontratës, se që gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur disa vonesa ne pagesat e faturave nga ana e Komunës së Prishtinës të cilat kanë shkaktuar disa vonesa në pagesat e furnitorëve dhe pagave të punonjësve. Megjithatë Komuna e Prishtinës edhe pse me vonesë ka kryer disa nga obligimet e saj çka ka bërë që gjendja të rikthehet në normalitet.

Si vazhdim i asaj çka cekëm më lartë, vlen të theksohet se përkundër vonesave në pagesa nga Komuna, ne si ndërmarrje në asnjë moment nuk kemi rrezikuar shërbimin e ushqimit për institucionet parashkollore, qendrat sociale, brigadën e zjarrfikëseve apo edhe ushqimin në shkolla me mësim tërëditor, pa çka se këto të fundit janë në pushimin e rregullt vjetor. Kjo lë të nënkuptohet për një menaxhim të nivelit të lartë profesional, fillimisht nga Kryeshefi Ekzekutiv, e më pas shtrirja e kësaj mënyre menaxhimi në nivelin e departamenteve.

Në kontekst të kësaj që ceka më lartë në raport me dërgimin e shujtave në sektorin publik, duke dite se menaxhoi kontratën me komunën, dua të ju rikujtoi serish se kontrata bazë me Komunën e Prishtinës skadon ne muajin nëntor të vitit 2025. Andaj duhet të punojmë që të mundësojmë vazhdimin e saj.

Sa i takon lëvizshmërisë së stafit tonë, në këtë periudhë kohore nuk kemi pasur lëvizje të stafit, por dua të theksoi se departamenti ynë konform shtimit të obligimeve në veçanti më shkollat me mësim terë ditor, kemi nevojë për plotësim të stafit, në veçanti në funksionin e shpërndarjes së ushqimit. Andaj pres mirëkuptimin tuaj, por edhe angazhimin që në përputhje me aktet normative të shtojmë stafin në këtë sektor.

Në tre muajt e dytë të këtij viti kemi vazhduar bashkë me zyrtarin e autoparkut të kujdesemi për mjetet e transportit të ushqimit, ku gjatë kësaj periudhe si njësi kërkues kemi bërë kërkesën tonë për nisje të procedurave tenderuese për servisimin e automjeteve tona, dhe presim që kjo procedurë të kryhet në përputhje me afatet e rregullta.

Sa i takon oborrit dhe higjienës kemi bërë një ndarje javore të stafit, nga të cilët kemi kërkuar përgjegjësi në mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme të ndërmarrjes, këtu duhet të theksojmë se kemi intervenuar në bashkëpunim me NPB-në në hapësirën pas objektit ku kemi bërë një kyçje te re e cila minimizon ndotjen bakteriale, por kemi për të përfunduar edhe demolimin e asaj çka në ndërmarrje njihet si “tarasa” e cila do shndërrohet në hapësirë të lirë fizike.

Krejt në fund, në këtë tre mujor kemi përfunduar edhe raportin final mbi projektin e strategjisë zhvillimore, i njëjti projekt presim se do të shërbej denjësisht në përmirësimin dhe modernizimin e punës në ndërmarrjen tonë, si dhe në veçanti presim që të përmirësohet edhe më shumë cilësia e ushqimit me menynë e re që ka dal nga ky projekt.


Departamenti i shitjes dhe marketingut


Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Shkollat Fillore, Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane), BPZ Zjarrfikësit dhe Qendrën Sociale për të moshuar.
Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.
Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e dytë të vitit 2025.


	Prill	**Maj**	**Qershor**
Institucionet Parashkollore Publike	28949	30531	26359
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	17334	16940	17108
Shkollat Fillore	45482	58940	26296
Qendrat Sociale	6600	6000	6000
Qendra Sociale për të moshuar	5250	5330	5330
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	2244	2294	2047
Shërbimet Catering	3 organizime 166 persona	2 organizime 190 persona	1 organizim 55 persona
Porosit private	5 biznese 1687 porosi	4 biznese 1459 porosi	4 biznese 1190 porosi

Ndërmarrja ka vazhduar shpërndarjen e shujtave ushqimore për Institucionet Publike Parashkollore dhe në ato me bazë në Komunitet, Shkollat Fillore, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendrat Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit. Po ashtu është bërë edhe shpërndarja e shujtave të nxehta dhe të ftohta në sektorin privat, ku gjatë kësaj periudhe të raportimit kemi pasur marrëveshje me pesë (5) operatorë privat dhe dhjetëra te tjerë ku ushqimet janë dërguar në baza ditore, bazuar në kërkesat specifike të klientëve.


Shpërndarja e shujtave nga Kuzhina (sektori publik) për periudhën TM2 2025
70000
60000
50000
40000
30000
20000
10000
0
Numri i shujtave
I.PUBLIKE
IP ME BAZE NE KOMUNITET
SHKOLLAT FILLORE
QENDRAT SOCIALE
QENDRA E TE MOSHUARVE
ZJARRFIKESIT
BPZ
Axis Title
PRILL
MAJ
QERSHOR


Shpërndarja e shujtave nga Kuzhina (sektori privat) për periudhën TM2 2025
Shitjet private
1190
1459
1687
0
200
400
600
800
1000
1200
1400
1600
1800
QERSHOR
MAJ
PRILL

Grafiku më poshtë paraqet ndryshimet në numrin e porosive private dhe shërbimeve catering gjatë periudhës tremujore TM2 (Prill, Maj, Qershor) për vitet 2024 dhe 2025. Të dhënat tregojnë një rënie të ndjeshme në të dy sektorët në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak.



Zyra për menaxhimin e kontratave

Ky raport ka për qëllim të përmbledh aktivitetet dhe përgjegjësitë që janë realizuar gjatë periudhës tre mujorit të dytë të vitit 2025 në lidhje me menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës për të siguruar që kontratat kanë qenë efektive dhe kanë sjellë rezultate të dëshiruara për palët sipas kritereve te përcaktuara ne kontratat aktive .
Aktivitetet kanë përfshirë shqyrtimin e kontratave, monitorimin e zbatimit të tyre, si dh evidentimin dhe mbikëqyrjen e proceseve të ndryshme lidhur me kontratat aktive si :

- Shqyrtimi i kontratave.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave.
- Raportimi dhe analiza e kontratave.
- Specifikimet e faturave apo flet-dërgesave.
- Konstatimi për pagesa për 18 kontrata aktive.

- Evidenca në specifikacione sipas flet-dërgesave dhe faturave që janë pranuar nga menaxherët e caktuar..

1. Raporti i Analizës Financiare - Ky raport shqyrton efektivitetin financiar të kontratës dhe koston totale të furnizimit per periudhën TM2 2025:

KONTRATAT ME AQP

		Prill	Maj	Qershor	**Total**
1	Lot 4 "Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor" Dauti Komerc SH.P.K 13.12.2024 deri 12.12.2025	€3,613.97	€4,059.64	€2,656.45	**€10,330.06**
2	Lot 3 dhe 5 Hajdini Comerc "Furnizim me artikuj të ndryeshëm ushqimor" 03.09.2024- 02.09.2025	€12,480.30	€10,024.10	€10,138.40	**€32,642.80**
3	Furnizimi me uje-Dauti	€20.00	€0.00	€295.68	**€315.68**
4	"Furnizimi me buke Premium Bakery " 02.12.2024 deri 03.12.2025	€14,758.85	€12,044.10	€13,077.50	**€39,880.45**
5	Mish gjedhi -Apetit sh.p.k	€7,223.50	€3,838.00	€341.60	**€11,403.10**
6	Lot 2 Mish pule- Beni Dona sh.p.k	€3,948.95	€3,764.13	€3,192.35	**€10,905.43**
7	Karburant Petrol Company 08.11.2024 deri 17.11.2025	€712.99	€852.63		**€1,565.62**

"Tremujori i dytë për vitin 2025, që përfshin muajt prill, maj dhe qershor, përfshin kontratat me AQP. Siç paraqitet më sipër, gjatë këtij tremujori është shpenzuar një shumë totale prej €107,043.14."

Përmbledhje Analitike (krahasues):

Gjatë Tremujorit të parë (Janar–Mars), janë shpenzuar gjithsej **€116,161.15.**

Në Tremujorin e dytë (Prill–Qershor), janë shpenzuar gjithsej **€107,043.14,** që tregon një ulje prej **7.85%** ose **€9,118.01** krahasuar me tremujorin e parë.

Rritje të konsiderueshme ka pasur te:

- Furnizimi me ujë **(+511.65%)**
- Mish pule **(+24.28%)**
- Lot 4 – Dauti Komerc -Furnizim me artikuj te ndryshëm ushqimor **(+11.65%)**

Ulje të dukshme ka pasur te:

- Mish gjedhi **(-45.43%)**
- Karburant **(-31.77%)**
- Furnizimi me bukë **(-9.08%)**

KONTRATAT ME KQ

		Prill	Maj	Qershor	
1	"Furnizimi me paketime ushqimore" Dauti Comerc 22.11.2024 deri 22.11.2024	€622.81	€1,353.60	€264.00	**€2,240.41**
2	"Furnizimi me artikuj ushqimor" Ananasi impex sh.p.k	€1,812.20	€443.00	€1,331.60	**€3,586.80**

3	"Pemë dhe Perime" Dauti Comerc	€3,039.70	€16,653.50	€11,369.95	**€31,063.15**
4	"Pem dhe Perime " Beni Dona 24.10.2024 deri 24.04.2025	€14,408.76	De active.	De active.	**€14,408.76**
5	"Furnizimi me higjienë" El Shpëtimi 09.10.2024 deri 09.10.2025	€0.00	€375.80	€369.10	**€744.90**
6	"Sigurimi Shëndetësor tek punëtorët" Sigma 29.09.2023 deri 29.09.2026	€1,984.00	€1,984.00	€1,959.20	**€5,927.20**
7	Planifikimi stretegjik	€10,000.00	€0.00	€0.00	**€10,000.00**
8	Furnizimi me vetura pikap per kuzhinen qendrore (marrje me qira) Delfin L.T.D VLERA	€7,984.00	€7,984.00	€7,984.00	**€23,952.00**
9	Biletat e autobusit për punëtorët Trafiku urban sh.a (90 punëtorë, vlera përfshihet për një vite dhe me mundësi te shtimit te punëtoreve te rijnë) menaxhere. Edona Vitija	Pages totale.			**€10,800.00**
10	Biletat e veçanta për staf (te hershum). Tringa	€714.00	€714.00		**€1,428.00**

	Ademaj (nuk ka vlere te caktuar)				

"Tremujori i dytë për vitin 2025, që përfshin muajt prill, maj dhe qershor, përfshin kontratat me KQ. Siç paraqitet më sipër, gjatë këtij tremujori është shpenzuar një shumë totale prej €104,151.22."

Përmbledhje Analitike (krahasuse):

Në Tremujorin I (Janar–Mars), janë realizuar shpenzime prej **€173,368.32**.
Në Tremujorin II (Prill–Qershor), shpenzimet janë **€104,151.22**, që përfaqëson një ulje prej **39.91%**, ose **€69,217.10** më pak.
Rritjet kryesore:

- Sigurimi shëndetësor (+6.22%)
- Marrja me qira e veturave (+€2,994.00)

Uljet më të theksuara:

- Higjiena dhe bileta të veçanta 30.85% dhe 33.58%

Fund!